

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË

Departamenti të Përgjithshëm
Divizioni Civil

GJYKATA THEMELORE
PRISHTINE PRISTINA
PRASHIA 1000000000

2018 OCT -1 AM 11: 52

PADITËSI: Mejdi BEKTASHI nga Prishtina, Rr. Anton Çeta, nr. 14

NR. SHKR. BR.SPISA

TË PADITURIT:

1. OJQ **ADMOVERE** (Transitional Justice | Education | Peacebuilding) pa adresë të përhershme, të përfaqësuar nga themeluesi **Shkëlzen Gashi**, me tel. +38344234842 që poashtu është edhe Botues i i këtij "HULUMTIMI"
2. **Luan Shllaku**, Drejtor Ekzekutiv, që është dhe financuesi dhe porositi i këtij "HULUMTIMI" **KFOS (Kosovo Foundation for Open Society)** nga Prishtina, Rr. Imzot Nik Prela, vila 13

Në bazë të nenit 4, paragrafi 1 lidhur me nenin 14, 17 dhe 19 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes Nr. 02/L-65, të lidhura me nenet 182 dhe 183 të LMD-së, si dhe neneve 297, 300 dhe nenit 306 të LPK-së Gjykatë së sipërshtuar i'a parashtrorë këtë:

PADI PËR SHPIFJE

me propozim për lëshimin e Masës së Përkoshme të Sigurisë

Vlera e kontestit 5.000,00 €

I. Përshkrimi i rastit

Me datën 25.09.2018 të paditurit në mënyrë të organizuar nëpërmjet një konference për shtyp dhe ueb - faqes së tyre si dhe përmes disa potabileve online dhe thuajse në të gjitha Televizionet Kombëtare kanë publikuar raportin me titull "**Stafi Akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet e profesorëve dhe përpjesa staf-studentë e studentë-hapësirë**" duke theksuar me sa vijon:

12. RASTI MEJDI BEKTASHI Në shkurt 2007 Gazeta «Express» boton një artikull me titull «Shumë plagjiaturë» për librin «Ekonomia» të autorëve Mejdi Bektashi e Nysret Gacaferrri. Në shkrim thuhet se «pjesa më e madhe e këtij libri është shkruar duke vjedhur» nga libri i autorëve të njohur botërorë Paul Samuelson dhe William Nordhaus, i botuar 14 herë në gjuhën kroate me titull «Ekonomija». Shkrimi madje citon paragrafë të tërë të vjedhur e të përkthyer me shumë gabime. Autorët nuk kanë reaguar ndonjëherë ndaj këtyre akuzave. Ndërsa Gacaferrri është pensionuar shumë vjet para se të zbulohej plagjiatura, Bektashi jo veç që vazhdon me qenë profesor në Juridik, por madje është avancuar.)

Provë: Kopja e raportit "Stafi Akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-studentë (Provë: Kopertina dhe fq.43)

Provë: Kopje e shkrimeve nëpër portalet e vendit

1. *Potali Kallxo.com* i datës 21.09.2018 <https://kallxo.com/publikohen-emrat-e-16-profesoreve-te-up-se-te-dyshuar-si-plagjiatore/>
2. *Gazeta RUBRIKA* e dt. 21.09.2018 <http://gazetarubrika.com/publikohet-raporti-stafi-akademik-i-up-se-nga-admovere/>
3. *Gazeta KOSOVA PRES* e dt. 21.09.2018 <http://ëëë.kosovapress.com/sq/lajme/publiko-emrat-e-16-profesoreve-qe-kryen-plagjiature-ne-up-180312/>

4. RTV 21 e dt. 21.09.2018 <http://rtv21.tv/publikon-emrat-e-16-profesoreve-qe-dyshohen-per-plagjiature-ne-up/>
5. RTV ZERI e dt. 21.09.2018 <http://rtvzeri.com/kosove/ja-emrat-e-16-profesoreve-plagjiature-up-se/>
6. Me bindje të plotë dhe përmes fakteve të shumta (që do ti prezantojë në seancë gjyqësore) dyshojë se ekziston një koordinim mirë i organizuar në mes të disa portaleve dhe shpifësve të paditur që të mos i botojnë reagimet e njerëzve të apostrofuar në këtë “HULUMTIM” të porositur dhe të financuar nga ana e KFOS-it. Si rast më eklatant mund të përmendi rastin e portalit **Kallxo.com**, i cili me datën 24.09.2018, përmes postës elektronike kërkon nga unë që të komentohen kinse të gjeturat e OJQ-së ADMOVERE. Padiësi në përgjigjeje me shkrim ka shpjeguar se këto të dhëna (ky “HULUMTIM”) që ka të bëjë me padiësin është shpifje e kulluar dhe tendencioze, e orkestruar nga individ të caktuar ndaj tij dhe autoritetit të tij, dhe për këtë padiësi ka ofruar prova zyrtare, përkatësisht vendimin e Senatit të Universitetit të vitit 2007, me nr. të protokollit 1/191 të dt. 10.05.2007, me të cilin ishte konstatuar se nuk bëhet fjalë për plagjiaturë, por për punim me të gjitha standardet shkencore, përkundër faktit se padiësi kërkoj që ky demant të botohet nga ky portal, për çudi ky demant deri më tani nuk është botuar.

Provë: Komunikimi përmes e-mailit dhe telefonit

II. SHPIFJA

Paditësi konsideron se publikimi i të paditurve në portable të ndryshme është Shpifje ashtu siç përcaktohet në nenin 3 pika a, b dhe c, të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes Nr. 02/L-65, ngase të paditurit, edhe pse e dinin se lidhur me këto shkrime të viti 2007 është zhvilluar një hetim nga profesorët kompetent të fushave përkatëse, (në mesin e tyre ishin edhe rezenzentë e librit) dhe pas hetimeve të detajuara komisioni ka konstatuar se libri i kontestuar nuk përmban asnjë element të plagjiaturës, koshient dhe me qëllim të njollosjes dhe degradimit të personalitetit tim, kanë publikuar në ueb faqen e vet deklaratë të pavërtetë dhe shpifëse, të cilat kanë dëmtuar rëndë reputacionin tim personal dhe akademik, si në aspektin moral emocional dhe shëndetësor. Se të paditurit kishin për qëllim të më shkaktojnë dëme me këtë shpifje, fletë edhe fakti se ata këto të pavërteta i plasuan në kohën kur unë isha në procesin e avancimit akademik, për të marr thirrjen më të lartë akademike; prof. i rregullt dhe në kohën kur fillon viti i ri akademik 2018/2019.

Se të paditurit kanë kryer aktin e shpifjes, në cilësi të provës, gjykatës i'a vë në disponim **VENDIMIN E SENATIT TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS me nr. 1/191 të dt. 10.05.2007** me të cilën konstatohen me sa vijon:

1. Se lidhur me bazën e njëjtë me datën 04.02.2007 Gazeta EXPRES në faqë 10.11 ka publikuar artikullin “shumë plagjiaturë” nga gazetari praktikant Jasmin Rexhepi;
2. Se lidhur me këtë çështje organi më i lartë akademik – Senati i UP-së, në vitin 2007, ka formuar një komision profesional në përbërje të cilit ishin tre (3) profesorë të Fakultetit Filologjik për të analizuar dhe hartuar një raport me shkrim për pretendimet e një gazetari

praktikant. Komisioni pas një analize disaditëshe ka konstatuar se libri **NUK ËSHTE PLAGJIAT**.

Provë: Kopja e vendimit të Senatit të UP –së nr. 1/191 dt. 10.05.2007,

Andaj, pa asnjë dyshim mund të vërtetohet se të paditurit gjatë publikimit të lajmeve të rrejshme e kanë ditur se janë duke e publikuar një lajm më përmbajtje të porositur dhe të pavërtetë. Është shumë indikative se kjo OJQ, por dhe disa të tjera, lajme të njejta shpifëse kundër profesorëve të UP-së i publikojnë në dy javët e fundit të qershorit dhe shtatorit, duke degraduar me tendenca të porositura dhe të caktuara në mënyrë publike një pjesë të stafit akademik të UP-së, pasi që në këtë kohë janë konkurset për pranimin e studentëve të rinj (edhe në Kolegjet private) dhe fillimi i vitit të ri akademik.

Po ashtu, është plotësisht e pasaktë se “autorët nuk kanë reaguar ndonjëherë ndaj këtyre akuzave”, pasi që ankesat nuk bëhen në OJQ por në organet akademike të UP-së dhe si rezultat i reagimit të koautorëve është formuar Komisioni profesional për verifikimin e kësaj shpifje të mëparshme që është vërtetuar dhe argumentuar përmes Vendimit të Senatit nr.1/191 të dt. 10.05.2007.

Ndërsa fjalia e parafundit se kinse “ndërsa Gacafferri është pensionuar shumë vjet para se të zbulohet plagjiatura” është një shpifje e rradhës dhe mostruoze nga të paditurit, pasi që kërkesa për verifikim është bërë në koordinim të përbashkët. Gjykata për të verifikuar këtë shpifje të rradhës mund ta thërret në çdo kohë profesorin e nderuar.

Në këtë rast vlerësojë se tendenca dhe veprimtaria e të paditurve është tërësisht e pabazë dhe qëllimkeqe. Përdormi i fjalëve "*plagjiaturë*" "*jo etike*" "*plagjiatë*", etj, etj, janë vetëm shpifje të kulluara dhe asgjë më shumë. Në fakt është tepër indikative se kush e përfaqëson dhe kush e financon këtë OJQ dhe pse të njejat nuk i raportojnë burimet e financimit si dhe shpenzimet e tyre, kur po të njejat me ngulm po “luftojnë” për transparencë sa më të madhe dhe qasjen e lirë dhe të papenguar në dokumente publike? Kush qenkan këta persona (si mundet të funksionoj një OJQ që mirret me “HULUMTIME” aq delikate e të specializuara pa patur një adresë të përhershme të selisë së saj) dhe cili është profili i tyre profesional e akademik që i japin vetës të drejtë të bëjnë “vlerësime hulumtuese, profesionale e akademike” të teksteve universitare dhe punimeve shkencore?

Qëllimi i paditësit në këtë rast nuk do të jetë përvetësimi i kompensimit të kërkuar jomaterial, pasi që nga tash zotohet se të gjitha mjetet do të barten në buxhetin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, si donacion me destinacion të veçantë për ndarjen e bursave studentëve më të dalluar dhe studentëve me gjendje të rëndë ekonomike.

Nga arsyet e paraqitura në referatën e padisë, paditësi propozon që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, vlerësimit të pretendimeve, administrimit të fakteve dhe provave relevante, në bazë nenit 182 të LMD-së, gjykata të marrë këtë:

AKTGJYKIM

1. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia dhe padia e paditësit MEJDI BEKTASHI nga Prishtinë si e bazuar dhe detyrohen të paditurit:

1. OJQ **ADMOVERE** (Transitional Justice | Education | Peacebuilding), pa adresë të përhershme, të përfaqësuar nga themeluesi **Shkelzen Gashi**, që poashtu është edhe Botues i i këtij “HULUMTIMI”
2. **Luan Shllaku**, Drejtor Ekzekutiv, që është financuesi dhe porositi i këtij “HULUMTIMI” **KFOS (Kosovo Foundation for Open Society)** nga Prishtina, Rr. Imzot Nik Prela, vila 13

a) Që në emër të dëmit jomaterial të paguaj secili veç e veç nga 125,000 € (njëqindnjëzetepesë mijë euro), në total prej 250,000 € (dyqindpesëdhjetë mijë euro), me kamatë ligjore, që paguan banka për mjetet e deponuara pa destinim të veçantë, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

2. DETYROHEN të paditurit që 7 (shtatë) ditë nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi të publikojë në ueb faqen e vet, në së paku 3 (tri) gazeta ditore dhe në të gjitha Televizionet Kombëtare kërkim faljen publike për shpifje ndaj paditësit Mejd Bektashi për të paktën 7 ditë radhazi.

3. DETYROHEN të paditurit që të largojë nga të gjitha faqet e internetit dhe faqet e tyre zyrtare e personale të gjitha shkrimet më përmbajte shpifëse të cilat i janë bërë paditësit dhe njëkohësisht të ndalojë publikimin e çfarëdo shpifje të re kundër paditësit Mejd Bektashi.

Me qëllim të ruajtjes së reputacionit të paditësit Mejd Bektashi nga shpifjet dhe dëmtimi i mëtutjeshëm i reputacionit, me theks të veçantë të publikimit të shpifjeve në ueb faqe të ndryshme të internetit dhe emetimin e tyre në media nga të paditurit: **1) ADMOVERE (Shkelzen Gashi)**, dhe **2) Luan Shllaku**, i propozojmë Gjykatës që në bazë të nenit 297 dhe 300 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në afatin sa më të shpejtë të sillni këtë:


AKTVENDIM

1. APROVOHET kërkesa e paditësit dhe CAKTOHET MASA E SIGURISË me të cilën I NDALOHET të paditurve: **1) ADMOVERE (Shkelzen Gashi)** dhe **2) Luan Shllaku**, publikimi i çfarëdo deklarate, prononcimi, njoftimi, informacioni, raporti, etj, në lidhje me personin Mejd Bektashi deri më sjelljen e Aktgjykimit nga Gjykata.
2. APROVOHET kërkesa e paditësit dhe CAKTOHET MASA E SIGURISË me të cilën URDHEROHEN të paditurit: **1) ADMOVERE (Shkelzen Gashi)** dhe **2) Luan Shllaku**, që t'i fshijë të gjitha Raportet dhe Deklaratat e publikuara, si dhe ta tërheqin nga qarkullimi “STUDIMIN” në fjalë që është shtypur në Printinpress, në tirazh prej 300 kopje, në lidhje me Mejd Bektashi -n të cilat janë të publikuara në mediat e shkruara, ueb faqe, faqe të internetit gjegjësisht rrjete sociale deri në nxjerrjen e Aktgjykimit nga Gjykata.

Prishtinë, më 28 Shtator 2018

Paditësi:

Mejd Bektashi



Tel.+38344502997



Universiteti i Prishtinës

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-244183

URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-244187

Mail: rektorati@uni-pr.edu

Rektori: Prof. Enver Hasani, PhD

enver.hasani@uni-pr.edu

+ 381 38 244 183

+ 381 38 244 186

+ 381 38 244 187 (fax)

Ref. nr.

11/191

Prishtinë

10.5.2007

Në bazë të nenit 28 pika 5, në lidhje me nenin 50 pika 1 të Statutit të Universitetit dhe nenit 6 pika 1 të Rregullores mbi Procedurat për Shqiptimin e Masave ndaj Stafit Akademik të UP-së në Rastin e Konstatimit të Plagjiaturave, marr këtë

VENDIM

- I. Libri "EKONOMIA", botimi i dytë i plotësuar, i autorëve Dr. Sc. Mejdi Bektashi dhe Mr. Sc. Nysret Gacaferri, botuar më 2005 në Prishtinë nga Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës, nga shtypshkronja "GRAFOBENI", i autorizuar si tekst universitar me vendimin e Këshillit Botues të UP-së nr. 117/36 të datës 12 qershor 1997, faqe 259; NUK ËSHTË PLAGJIAT NË KUPTIM TË VENDIMIT TË SENATIT TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS NR. 112, DATË 12 JANAR 2007 MBI MBROJTJEN E PRONOSISË INTELETKUALE.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ARSYETIM

Gazeta "EXPRESS" e datës 4 shkurt 2007 ka botuar shkrimin me titull "SHUMË PLAGJIATURË", fq. 10-11. Autori i shkrimit ka qenë Jasmin Rexhepi, i cili ka pohuar se libri në fjalë nga pika I e këtij vendimi është plagjiatë i rëndë.

Senati i Universitetit të Prishtinës më datën 12 janar 2007, nr. 112, ka formuar një komision permanent mbi mbrojtjen e pronësisë intelektuale për rastet kur librat mbajnë shenjë dalluese të Universitetit të Prishtinës. Vendimi mbi formimin e këtij komisioni mban numrin rendor 112.

Komisioni i lartpërmendur i Senatit të UP-së, me rastin e marrjes në shqyrtim të pohimeve nga gazeta "EXPRESS" lidhur me librin e autorëve nga pika një e këtij vendimi është plotësuar me kërkesën e Rektorit të UP-së më datën 20 mars 2007, me dy anëtar të rinj dhe atë me: Prof. Dr. Ruzhdi Ushaku nga katedra e gjuhës dhe letërsisë frënge të Fakultetit të Filologjisë dhe Mr. Sc. Albulena Blakaj nga dega e gjuhës dhe letërsisë gjermane e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Komisioni kur ka shqyrtuar rastin në fjalë ka qenë në përbërjen për sa vijon:

- Prof. Dr. Halit Halimi
- Mr. Sc. Albulena Blakaj dhe
- Prof. Dr. Ruzhdi Ushaku

Emrat e anëtarëve të Komisionit nuk janë bërë publik gjatë kohës së punës së tyre për shkak të dyshimeve të bazuara se mund t'i ekspozohen formave të ndryshme të presionit.

Këshilli Drejtues i UP-së, me propozim të Rektorit të Universitetit ka miratuar Rregulloren mbi Procedurat për Shqiptimin e Masave ndaj Stafit Akademik të UP-së në Rastin e Konstatimit të Plagjiaturave, datë 17 prill 2007, me të cilin përcaktohen procedurat

dhe masat për rastet e konstatimit të plagjiaturave konform vendimit të Senatit nr. 112 , datë 12 janar 2007.

Komisioni pas një analize disaditëshe ka konstatuar se libri nga paragrafi i parë i këtij vendimi NUK ËSHTË PLAGJIAT i librit në gjuhën kroate "EKONOMIJA", i autorëve Paul A. Samuelson dhe Vilijam D. Nordhaus, botuar më 1992 nga MATE, i cili në original është në gjuhën angleze, ashtu siç kërkojnë dispozitat e vendimit të Senatit nr. 112 të datës 12 janar 2007.

Ekspertiza e bërë nga Komisioni dhe Vendimi i datës 12 janar 2007, nr. 112 , si dhe Rregullorja mbi Procedurat për Shqiptimin e Masave ndaj Stafit Akademik të UP-së në Rastin e Konstatimit të Plagjiaturave e datës 17 prill 2007, i kanë shërbyer Rektorit si bazë për vendimmarrje dhe konstatim se nuk ka vend për përgjegjësi për plagjiat të autorëve Asistent Profesor Mejdi Bektashi dhe Mr. Sc. Nysret Gacaferri, dhe mbi këtë fakt të vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë Juridike : Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në afatin prej tetë ditësh. Ankesa i drejtohet Senatit të UP-së.

Vendimi iu dërgohet:

- Palëve: Ass. Prof. Mejdi Bektashi e Mr. Sc. Nysret Gacaferri
- Dekanit të Fakultetit Juridik , Ass. Prof. Hava Bujupi
- Senatit të UP-së
- Arkivit të UP-së

Prishtinë, 10 maj 2007

REKTORI
Prof. asoc. Enver Hasani



Pyetje nga KALLXO.com [Inbox x]



Liridona Ademaj <liridonaademaj@jetanekosove.com>
to me ▾

Mon, Sep 24, 4:45 PM (3 days ago) ☆ ↶ ⋮

Albanian ▾ > English ▾ Translate message

Turn off for: Albanian x

Pershendetje i nderuar,

Shpresoj se jeni mire. Jam Liridona Ademaj, gazetare ne KALLXO.com.

Po ju shkruaj per t'ju pyetur rreth raportit qe eshte publikuar nga organizata Admovere me titull "Stafi akademik i UP-se", ku ne kapitullin e trete te titulluar "Plagjiatura e stafit akademik" jane përmblodhur emrat e 16 profesoreve.

Mes te dyshuarve qe kane kryer plagjiature ne punime, gjendet edhe emri juaj ku thuhet se ju keni marre nga libri "Ekonomia" e autoreve Paul Samuleson dhe William Nordhaus.

A mund te na tregoni se si e komentoni ju kete raport, cila eshte e verteta sipas jush?

Bashkengjitur mund te gjeni edhe raportin e publikuar:

http://admovere.org/wp-content/uploads/2018/07/admovere_plagjiaturaUP_ALB_web.pdf

Faleminderit per kohen. Pres pergjigjen tuaj.

Gjithe te mirat,

Liridona Ademaj



Mejd Bektashi <mejd.bektashi@uni-pr.edu>
to Liridona ▾

Tue, Sep 25, 12:02 AM (2 days ago) ☆ ↶ ⋮

Prsh. Liridona

Tash e lexova emalin e juaj dhe jam i gatshem te komentoj kete raport te nje NGO te financuar nga Kfosi (sorosi), Une mund te flas gjate e gjate si per porositesin e keti pamfleti por edhe per financuesin.

Se pari, ajo qe shkruhet ne kete raport eshte shkrimi i nje gazetari mercenar te eksprisit te atehershem per te cilin nuk besoj se dikush e njej. SENATI i UP ne vitin 2007 ka formuar nje komision te pavarur nga 3 profesor eminent te fak.filologjik (ne attachment po ju dergoj kopjen e ketij vendimi) ku ne menyre decisive thuhet se) ju lutem lexone me vemendje dhe mund te jepni komente.

Nese nuk i besoni keti vendimi merne librin ne fjale dhe librin e autoreve amerikan qe tani eshte perkthyer edhe ne gjuhen shqipe dhe krahasoni,per tu bindur se gjithcka eshte e cituar dhe citimet jane ne

" "

Sa i perket ketyre konstatimeve te nje NGO shume profitabile une qe nesor do te dorezoj nje kaxhim penal dhe padi per cpifje qe ne cdo shtet demokratik eshte e ndeshkueshme.

Por ju si gazetar eshte mire qe te parashtroni pyetjen se sa eshte pagu ky projekt dhe nga sa mija euro jane paguar punekryesit.

Do te deshiroja qe per kete teme te kemi nje interviste nese ju lejojn qe ti botoni disa dokumente e fakte te shkruara per disa porosites te ketyre "analize a studimeve". Para se ta botoni kete pergjigjeje ju lutem qe te me kontaktoni ne nr. 044502997.

Ju kerkoje falje per vonesen e oergjigjejes.



Mejd Bektashi <mejd.bektashi@uni-pr.edu>
to Liridona ▾

Wed, Sep 26, 4:07 PM (20 hours ago) ☆ ↶ ⋮

prsh. Liridona

Sot prita qe do ta botoni pergjigjen time ndaj akuzave qe i behen personalitetit tim nga nje NGO qe per baze nuk merr fakte notore po sherbehet me shkrime te porositura para 12 viteve. Po te kisha ditur se do te jeni kaq te njeanshem nuk do te isha pergjigjur ne kerkesen e juaj per koment.

Mbetem ne shprese se e verteta do te publikohet dhe opinjoni kosovar do te informohet ne menyre objektive. klm e pres pergjigjen e juaj

